

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-099/2014**

**Prishtinë,  
14 Korrik 2016**

Në çështjen juridike të:

**B. J. si trashigimtar i N. J.**

***Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë***

kundër.

**S. R.M.si trashigimtare e R. O.**

***Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi e kërkesës***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krasimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA93046), të datës 27 Nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Korrik 2016, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 të datës 27 Nëntor 2013, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA93046
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 i datës 27 Nëntor 2013, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA933046.

### Përmbledhja faktike dhe procedurale:

1. Më 31 Maj 2007 S. R. M. *(në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse)* ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës *(në tekstin e mëtejme: AKP)* ku ka kërkuar të drejtën pronësore dhe riposëdimin e pronës që evidentohet në emër të babait të saj të ndjerë R. O. dhe atë ngastrat kadastrale nr. 503/1 dhe 503/2, në sipërfaqe prej 52 ar 41 m<sup>2</sup>, e evidentuar në Fletën Poseduese nr. 140, Zona Kadastrale Shajkovc/Sajkovac, Komuna e Podujevë/Podujevo *(në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar)*. Fillimisht ajo kishte kërkuar edhe ngastrën kadastrale 504 por AKP-ja e kishte ndarë kërkesën e veçantë për këtë pronë. Ajo ka deklaruar se prona shfrytëzohet nga persona të panjohur pa asnjë të dejtë ligjore.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kerkesës në mes tjerash ka paraqitur edhe këto dokumente:
  - Fleta poseduese Nr. 140 datë 26 Prill 2007 lëshuar nga Enti për Kadstëe dhe Palujtshmëri i Podujevë/Podujevo, që dëshmon se ngastra kadastrale 503/1 me sipërfaqe prej 0.45.32 h metra katrorë, arë e klasit të IV-të dhe ngastra 503/2 me sipërfaqe prej 0.07.09 h janë të evidentuara në emër të R. O, babai i paraqitësit të kërkesësë;
  - Letërnjoftim lëshuar nga Autoritetet paralele të dislokuara në Serbi me 12 Shatator 2001 me adresë banimi në Prishtinë;
  - Certifikatë e martesës që dëshmon se paraqitësja e kërkesës është e bija e R.
  - Kopje e planit datë 24 Dhjetor 2010 në të cilën emri i pronarit figuron R. O.

3. Me datën 11 Qershor 2013 AKP-ja kishte vendosur njoftimin për kërkesën dhe e kishte konstatuar se njoftimi ishte i sakët në bazë të GPS koordinatave.
4. Me 3 Korrik 2013 B. J. (më tej pala ankuese) ishte përgjigjur në kërkesë dhe kishte deklaruar se prona ishte konfiskuar pa asnjë kompensim gjatë Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene duke iu dhene palës përgjegjëse e cila e ka shfrytëzuar deri më 1999. Me vonë kishte deklaruar se prona ishte blere në vitet e 1980 por nuk ishte regjistruar dhe se fundmi me Aktgjykim të Gjykatës Komunale në Podujevë/Podujevo i vitit 2008 ishte bërë pronar i pronës së kërkuar
5. Në mbështetje të përgjigjes pala përgjegjëse në kërkesë ka paraqitur këtë dokumentacion:
  - Aktgjykimin C.nr.158/2008 i formës së prerë me 7 Tetor 2008 me të cilin aprovohej kërkespacia e B.J. dhe vërtetohej se i njëjti ishte pronarë i ngastrave 503/1,503/2
  - Certifikata e pronësisë datë 19 Nëntor 2012 janë regjistruar në emër të B.J.;
6. Më 27 Nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/219/2013, konstatoi se R. P. O. babai i paraqitëses së kërkesës kishte dëshmuar se është pronar 1/1 i ngastrës 503/1 dhe 503/2, dhe se palës përgjegjëse i kthehej posedimi dhe urdhëroheshin personat tjerë që brenda 30 ditës ta lirojnë pronën nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
7. Në paragrafët 81-88 të vendimit Komisioni arsyeton se pala përgjegjëse-paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se bartësi i së drejtës pronësore ishte pronar para konfliktit të armatosur. Pala përgjegjëse kishte paraqitur dëshmi Aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës komunale në Podujevë/Podujevo i cili dëshmonte se gjykata i kishte njohur pronësinë palës ankuese në vitin 2008 në një procedurë pa pjesëmarrjen e palës përgjegjëse në ankesë; Komisioni kishte mbajtur seancë dëgjimore me 21 Gusht 2013. Pala ankuese në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë i referohej Aktgjykimin të Gjykatës por ka pranuar se pala përgjegjëse në ankesë ka qene ne posedim deri ne vitin 1999 edhe pse siç deklaroi ai me regjistra kadastral ai ka qene pronar. Komisioni ka konstatuar se Gjykata nuk ka pas juridiksion mbi këtë çështje dhe pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme dhe kërkesa duhej aprovuar.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 31 Mars 2014, ndërsa palës përgjegjëse në ankesë i është dorëzuar me datë 29 Prill 2014. Më 30 Prill 2014, pala përgjegjëse në ankesë e ka kundërshtuar vendimin në Kolegjin e Apelit të AKP-së të

Gjykatës Supreme. Ankesa e ushtruar nga pala ankuese i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më datë 21 Maj 2014, ndërkaq me datën 13 Qershor 2014 ajo ka paraqitur edhe përgjigje në ankesë. Gjykata Supreme e ka pranuar dosjen e lëndës më 20 Maj 2014.

**Pretendimet e palëve:**

*Pala ankuese/Pala përgjegjëse në ankesë:*

9. Pala ankuese në ankesën e tij të ushtruar pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor, se mbështetet në vlerësimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale.
10. Pala ankuese pretendon se çështja është zgjidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë dhe se në seancën dëgjimore nuk ka ardhur askush nga pala përgjegjëse në ankesë e as dëshmitaret e propozuar më tej pala ankues pretendon se i është mohuar e drejta që të ketë kërkesën e palës tjetër dhe dokumentet mbështetës.
11. Në ankesën e tij të ushtruar pranë Gjykatës Supreme, pala ankuese ka përsëritur pothuajse të njëjtat pretendime si edhe ato të shfaqura para AKP/KKPK-ës gjatë seancës dëgjimore, Prandaj, pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës, që ankesa e tij të shqyrtohet dhe vendimi i ankimuar të ndryshohet, ndërsa lënda t'i kthehet AKP/KKPK-ës për rivendosje.

*Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës:*

12. Pala përgjegjëse në ankesë duke u përgjigjur ka pohuar se babai i saj kur nuk e ka shitur pronën e kërkuar dhe se ka qenë në posedim të papenguar deri në qershor të vitit 1999. Më tej ajo thekson se Aktgjykimi i Gjykatës është marrë pa prezencën dhe dijeninë e saj dhe të ndonjë anëtari të familjes së saj. Përfundimisht i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzoi ankesën si të pa merite dhe ta vërtetoi Vendimin e KKPK-së

**Arsyetimi ligjor**

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*këtej e tutje Ligji nr. 03/L-079*) dhe është e pranueshme.
14. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së në mesin e dokumenteve të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë, ka verifikuar pozitivisht Fletën Poseduese nr. 140. Kjo Fletë Poseduese konstaton se prona e kërkuar është regjistruar në emër të babait të palës ankuese.
15. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i ankimuar gjithashtu bazohet edhe në faktin se pala ankuese e mbështetë pretendimin e vet në Aktgjykimin C.nr.158/2008 i formës së prerë me 7 Tetor 2008 me të cilin aprovohej kërkespadia e B. J. dhe vërtetohej se i njëjti ishte pronarë i ngastrave 503/1,503/2 dhe se i njëjti ishte marrë jashtë juridiksionit bazuar në dispozitat e nenit 11.4 (c) që parasheh se *“Komisioni e refuzon kërkesën në tërësi apo pjesërisht kur: (c) Kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë”*. Në rastin konkret, pala ankuese kishte paraqitur padinë në Gjykatën Komunale me 15 Prill 2008 dhe aktgjykimi ishte marrë pasi që rregullorja e UNMIKUT-ut 2006/50 e amandametuar me Ligjin nr. 03/L-079 kishte hyrë në fuqi (16 Tetor 2006). Sipas nenit 18 të rregullores së UNMIKUT-ut 2006/50 e amandametuar me Ligjin nr. 03/L-079 dispozitat e këtij ligji aplikohen në secilën kërkesë në përputhje me nenin 3.1 të Ligjin nr. 03/L-079 që parasheh se KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e këtyre kategorive të kërkesave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të që përfshijnë rrethana që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: a) kërkesat e pronësisë sa i përket pronës së paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe b) kërkesat që përfshijnë të drejtat e shfrytëzimit të pronës sa i përket pronës së paluajtshme private, ku paraqitësi i kërkesës për të dyja kategoritë tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore. Pasi që kërkesa ishte paraqitur në Gjykatën Komunale me datën 16 Tetor 2006, KKPK-ja ishte kompetente për të vendosur për kërken.
16. Për Gjykatën është i drejtë dhe ligjshëm konstatimi në vendimin e KKPK-ës, pala përgjegjëse-paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se është pronar kurse pala ankuese nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme dhe për këto arsye kërkesa duhej aprovuar. Prandaj, nga kjo Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet ankimore të palës ankuese janë pa baza dhe të papranueshme për sa i takon të drejtës pronësore në pronën e kërkuar.

17. Me këtë rrjedhimisht pala ankuuese nuk ka arritur të dëshmojë në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë pronësore të tij në pronën e kërkuar, siç edhe nuk ka arritur edhe të atakoj sukseshëm konstatimin e KKPK-ës të dhënë në vendimin e se pala përgjegjëse është pronare e pronës së kërkuar.
18. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja vendimin e saj të drejtë dhe valide e ka mbështetur në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe nuk janë gjetur shkelje të dispozitave procedurale e matriale. Prandaj, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se ankesa është e pabazuar.
19. Duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, në pajtim me nenin 13.3 nën pikën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gutaityde, Referent i EULEX-it**